



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARIA M. DANO  
ADRESA Mihal Duri, Nr. 4  
TEL: 694099966

# VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI DHE STATUTI)

Nr. repertori: 5957

Tirane më 24/10/2023

Maria  
Dano



Firmosur elektronikisht nga  
NISA me certifikaten :Maria  
Dano  
Data: 2023.10.25  
11:23:08+02:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023053190493876038



**AKT THEMELIMI**  
**i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar**  
**“GLOBUS INVESTMENT” SH.P.K.**

Sot, me 24/10/2023, unë i nenshkruari, **Astrit Gjonpalaj**, atësia Lulash, amësia Sose, shtetas Shqiptar, lindur në Peraj, Tropoje dhe banues në Tiranë, lindur më 22/03/1976, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i Pasaportes me Nr. H60322105N.

Regjistroj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin “GLOBUS INVESTMENT” Sh.p.k.,

**Neni 1**

Unë i sipërpërmënduri, me vullnetin e tim të lire dhe te plote dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendos që te krijoj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin “GLOBUS INVESTMENT” Sh.p.k., me kapital themeltar 100 Leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tiranë ne adresen: Rruga Mine Peza, p. 118, Tiranë, Shqipëri.

Ortak i kësaj shoqerie do te jetë, **Astrit Gjonpalaj**.

Shoqeria “GLOBUS INVESTMENT” Sh.p.k., ka te drejte te krijojë filiale brenda dhe jashte Shqiperise, ne menyrat dhe me kohezgjatje ashtu sikunder e konsideron te arsyeshme, dhe me miratimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Kompania gazon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.

**Neni 4**

**Objekti i shoqerise :**

Ndertim, blerje shitje prona te paluajtshme si dhe cdo veprimtari tjetër te lejuar sipas ligjeve ne fuqi.

**Neni 5**

Kapitali fillestar i kompanise do te jete 100 leke me 1 (një) kuote, nga e cila:

**Astrit Gjonpalaj** zoteron një kuote me vlere nominale 100 (njëqind), leke, 100 % te kapitalit themeltar te shoqerisë.

Kapitali themelor eshte depozituar nga ortakët ne emer te shoqerise. Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet, pervec ketij akti themelimi, me normat e vendosura ne Statut, kundrejt nenshkrimit te ortakeve, dhe aprovimit nga Qendra Kombetare e Biznesit, ditën qe do te marre cilesine e personit juridik.



#### **Neni 6**

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktivitetet e kompanise do te ndahet midis ortakeve ne perpjesetim me aksionet e tyre ne kompani. Çdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vet te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

#### **Neni 7**

Per borxhet qe mund te ezistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar. Anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

#### **Neni 8**

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.

#### **Neni 9**

Marredheniet e punes ne shoqeri apo deget e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.

#### **Neni 10**

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesaj shoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj.

#### **Ortaku Themelues**

**Astrit Gjonpalaj**



**STATUTI**  
**i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**  
**“Globus Investment” SH.P.K.**

Parashikimet e këtij Statuti zbatohen për një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK).  
Ne kete statut:

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;
- QKB” – Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri.

**KREU I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Me date 24/10/2023, unë i nënshkruari:

**Astrit Gjonpalaj**, atësia Lulash, amësia Sose, shtetas Shqiptar, lindur në Peraj, Tropoje dhe banues në Tirane, lindur më 22/03/1976, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtes i Pasaportes me Nr. H60322105N.

Regjistroj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Globus Investment” Sh.p.k., bazuar në akt themelimit të datës 24/06/2022.

**Neni 2**  
**Objekti**

2.1 Ndertim, blerje shitje prona të paluajtshme si dhe çdo veprimtari tjetër të lejuar sipas ligjeve në fuqi.

Gjithashtu shoqëria mund të ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur me sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

**Neni 3**  
**Kohezgjatja**

3.1. Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar.

**Neni 4**  
**Selia**

4.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresën: Tiranë në adresën: Rruga Mine Peza, p. 118, Tiranë, Shqipëri

**KREU II**





## Kapitali

### Neni 5

#### Kapitali themeltar

5.1 **Astrit Gjonpalaj** zoteron një kuote me vlere nominale 100 (njëqind), leke, 100 % te kapitalit themeltar te shoqerisë.

5.2. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

### Neni 6

#### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

6.1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

6.2. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

6.3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

6.4. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

7.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

7.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

## KREU III

### Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese

### Neni 8

#### Organi Vendimmarres

8.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

8.3. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:



- a) percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
  - ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar;
  - d) percaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4. Ortaku mund të përfaqësohet në asambletë të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asambletë të përgjithshme.
- 8.6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese të përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

##### **Menyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese të Përgjithshme**

- 9.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.
- 9.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10**

##### **Kuorumi**

- 10.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- 10.2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 11**

##### **Marrja e vendimeve**





11.1. Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

11.2. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
  - b) emerimin dhe shkarkimin e administratorevc;
  - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
  - ç) percaktimin e shperblimeve
  - d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- 11.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### Neni 12

##### Perjashtimi nga e drejta e votes

12.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

12.2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

#### Neni 13

##### Administrimi

13.1. Asambleja e pergjithshme emerom nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte ripertesitjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

13.2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundershtrim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

13.3. **Z. Astrit Gjonpalaj** eshte Administrator i shoqerise deri ne emerimin e tij nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

#### Neni 14

##### Kompetencat e Administratoreve

14.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se



veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;

d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;

dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;

e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

14.2. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.3. Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

14.4. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## Neni 15

### Pergjegjesite e Administratorit

15.1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

15.2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

15.3. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

15.3.1. a) te kryejte detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

15.3.2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

15.3.3. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te këtij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane





realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

15.4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'I demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtrim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

- a) ukthen ortakeve kontributet;
- b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

15.5. Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padisc kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### **KREU IV** **Viti financiar-ekspertet**

##### **Neni 16** **Viti Financiar**

16.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17** **Ekspertet**

17.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithhevjeter dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'I shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

#### **KREU V** **Prishja –riorganizimi i shoqerise**

##### **Neni 18** **Prishja dhe likuidimi**

18.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;



- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";
- d) me vendim te gjykates;
- 18.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqeri ne likuidim e siper".
- 18.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.
- 18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.
- 18.5. Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

#### Neni 19

##### Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

- 19.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

#### Neni 20

##### Baza Ligjore

- 20.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 20.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

### ORTAK I SHOQERISE

Astrit Gjonpalaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MARIA M. DANO



V2023053190493876038

DATE 24/10/2023  
NR REP 5957

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 24/10/2023 , para meje Notere MARIA M. DANO, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Mihal Duri, Nr. 4, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES:** Z. Astrit Gjonpalaj, atësia Lulash, amësia Sose, shtetas Shqiptar, lindur në Peraj, Tropojë dhe banues në Tiranë, me adresë Sami Frasheri; Nd. 1827; H. 0; Ap. 051; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 22/03/1976, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035986033 dhe nr. personal H60322105N.

**Subjekti mësipërm, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përpara meje Noteres, “Akt Themelimi dhe Statuti i shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar “GLOBUS INVESTMENT” SH.P.K. bashkëlidhur këtij vertetimi.**

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma “ë”, si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MARIA M. DANO

